

VENDIM
Nr. 190, datë 27.3.2024

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR MENAXHIMIN E
QËNDRUESHËM TË PYJEVE DHE ZONAVE TË MBROJTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19 të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe zonave të mbrojtura, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË
PËR MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË PYJEVE DHE ZONAVE TË
MBROJTURA

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë në vijim të referuara si “Palët”.

Duke marrë parasysh rëndësinë lokale, rajonale dhe globale të pyjeve dhe zonave të mbrojtura, si zona me vlera të jashtëzakonshme mjedisore, ekonomike, shkencore, estetike dhe kulturore,

të bindur se memorandum i mirëkuptimit është thelbësor për ruajtjen e këtyre vlerave për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, nëpërmjet një metode menaxhimi që siguron mbrojtjen, rritjen dhe menaxhimin si të fondit pyjor, ashtu edhe të zonave të mbrojtura, duke i mundësuar zhvillimin e qëndrueshëm të tyre,

të vetëdijshëm për nevojën për qasje të integruar për mbrojtjen dhe ruajtjen e integritetit të fondit pyjor kombëtar dhe ekosistemeve tokësore dhe bregdetare të zonave të mbrojtura,

duke njohur detyrimet përkatëse, në veçanti për Konventën e OKB-së për Diversitetin Biologjik, Konventën Kuadër për Ndryshimet Klimatike, Konventën e OKB-së për Luftimin e Shkretëtirëzimit, Konventën e Ramsarit, Konventën për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror të Evropës (Konventa e Bernës),

duke synuar thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit për të siguruar një të ardhme më të mirë për mjedisin që do t’u vlejë brezave,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Objekti

1. Ky memorandum mirëkuptimi synon të zgjerojë bashkëpunimin dypalësh drejt mbrojtjes së mjedisit për të mbuluar një sërë fushash tematike të rëndësishme mjedisore, të tilla si: ruajtja e

biodiversitetit dhe menaxhimi i integruar i zonave të mbrojtura, mbrojtja e detit nga ndotja, menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore, luftimi i shkretëtirëzimit të tokës, duke reduktuar erozionin e saj.

2. Memorandumi i mirëkuptimit synon të rrisë bashkëpunimin nëpërmjet palëve nëpërmjet shkëmbimit të njohurive, përvojës dhe teknologjisë mbi bazën e barazisë, reciprocitetit dhe përfitimit të ndërsjellë, me qëllim reduktimin e ndotjes së mjedisit dhe garantimin e qëndrueshmërisë mjedisore, si dhe mbrojtjen dhe përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të biodiversitetit dhe burimeve natyrore.

3. Ky memorandum mirëkuptimi synon gjithashtu të krijojë një vizion për menaxhimin e qëndrueshëm të Fondit Pyjor Kombëtar Shqiptar dhe të ndihmojë dhe mbështesë Ministrinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë së Turqisë, në drejtëm të përmirësimit të menaxhimit të zonave të mbrojtura në Shqipëri, nëpërmjet bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojës, profesionalizmit dhe ekspertizës turke, me synim zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Palët marrin përsipër të bashkëpunojnë për të arritur mbështetje dhe ndihmë konkrete për sa i përket:

a) përmirësimit të situatës së pyjeve në Shqipëri si mbajtësit kryesorë të biodiversitetit, si stabilizues të ndryshimeve klimatike dhe peizazheve natyrore, si dhe burimi kryesor thelbësor natyror;

b) forcimit dhe efektivitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura;

c) kryerjes së disa trajnimeve për ekspertët shqiptarë në Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit në Antalia, të zhvilluara me mbështetjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë;

d) pyllëzimit dhe rikuperimit të pyjeve të dëmtuara ku pala turke e çmon të nevojshme;

e) përvojës, ekspertizës dhe mbështetjes për planet e menaxhimit dhe praktikat më të mira për zonat e mbrojtura;

f) forcimit të bashkëpunimit në të gjitha nivelet, duke ftuar njëri-tjetrin për të marrë pjesë në evente mjedisore dhe shkencore;

g) shkëmbimi i përvojave dhe mësimi nga njëri-tjetri do të shërbejë si bazë për aktivitetet e përbashkëta që do të ndërmerren;

h) përpilimit të bazës së të dhënave me zonat me rrezik të lartë të zjarreve në pyje;

i) krijimit të Qendrës Kombëtare të Koordinimit dhe Monitorimit të Zjarreve në Pyje;

j) aplikimit të modeleve të bazuara në ekosisteme nëpërmjet menaxhimit të integruar;

k) ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura;

l) luftës kundër shkretëtirëzimit, teknikave të pyllëzimit, prodhimit të fidanëve, teknikave të fidanishteve dhe kontrollit të erozionit;

m) mbështetjes për krijimin e regjistrit të ri pyjor dhe hartimin e dokumenteve teknike si libër normash, standarde dokumentesh etj.;

n) zhvillimit të sistemeve të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit në kontekstin e Konventës kuadër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), Konventës së OKB-së për Luftimin e Shkretëtirëzimit (UNCCD), Konventës së OKB-së për Diversitetin Biologjik (UNCBD).

Neni 3

Mënyrat e bashkëpunimit

Për të arritur qëllimet e përcaktuara në nenin 2, Palët do të marrin masat e nevojshme, individualisht ose në bashkëpunim, për:

a) zhvillimin e përbashkët të turizmit miqësor ndaj natyrës;

- b) ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që e bën tërheqës stilin e jetesës së brezit të ri;
- c) promovimin e përbashkët të trashëgimisë së veçantë natyrore dhe kulturore përtej kufijve;
- d) promovimin dhe ruajtjen e njohurive dhe praktikave tradicionale bujqësore për të mbrojtur tokën nga erozioni, varfërimi, infeksionet dhe ndotja;
- e) ruajtjen e biodiversitetit, veçanërisht mbrojtjen e specieve endemike, të rralla, të kërcënuara ose të rrezikuara të florës dhe faunës;
- f) parandalimin e futjes dhe mbarështimit të specieve, bimëve dhe kafshëve jovendëse.

Neni 4

Autoritetet kompetente

Autoritetet kompetente përgjegjëse për zbatimin e këtij memorandum mirëkuptimi, janë si më poshtë vijon:

1. Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
2. Në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë; Ministria e Bujqësisë dhe Pylltarisë.

Neni 5

Detyrimet e ndërsjella të palëve

1. Çdo Palë do të emërojë një koordinator kombëtar, i cili do të jetë përgjegjës për menaxhimin e fushave të bashkëpunimit të listuara në memorandum, brenda 3 (tre) muajve pas hyrjes në fuqi të memorandumit të mirëkuptimit.

2. Palët do të shkëmbejnë ekspertë në fushat për të cilat është rënë dakord. Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit do të mbulohen nga palët dërguese.

Neni 6

Shpenzimet

Zbatimi i memorandumit të mirëkuptimit nuk ka asnjë detyrim apo efekt financiar për Palët e përfshira.

Neni 7

Ndryshimet

1. Ky memorandum mirëkuptimi mund të ndryshohet me pëlqim të ndërsjellë me shkrim ndërmjet palëve.

2. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me të njëjtën procedurë ligjore të parashikuar në nenin 9.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum mirëkuptimi do të zgjidhet me mirëkuptim nga Palët nëpërmjet konsultimeve ose negociatave.

2. Në rast se nuk arrihet konsensus nga palët në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, mosmarrëveshja do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky memorandum mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me të cilin palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të dokumentit në fjalë.

Neni 10

Kohëzgjatja dhe përfundimi

Ky memorandum mirëkuptimi lidhet për 5 (pesë) vjet dhe do të rinovohet automatikisht për periudha të njëpasnjëshme prej 5 (pesë) vjetësh, përveç nëse njëra nga Palët njofton Palën tjetër me shkrim me anë të kanaleve diplomatike, me qëllim përfundimin e memorandumit të mirëkuptimit 60 (gjashtëdhjetë) ditë para mbarimit të afatit.

Secila Palë mund të përfundojë këtë memorandum mirëkuptimi në çdo kohë, duke i dhënë Palës tjetër njoftim me shkrim për këtë qëllim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, ky memorandum mirëkuptimi do të ndërpritet 3 (tre) muaj pas datës së njoftimit.

Përfundimi i këtij memorandum mirëkuptimi nuk do të ndikojë në zbatimin e ndonjë aktiviteti apo projekti në vazhdim, përveç nëse të dyja Palët bien dakord ndryshe me shkrim.

Bërë në _____, më _____, në dy kopje origjinale dhe në gjuhën shqipe turke dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të ndonjë divergjence në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Mirela Kumbaro Furxhi
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
TURQISË
İbrahim Yumaklı
MINISTËR I BUJQËSISË DHE PYLLTARISË